



Pranuar / Doretuar Prilimje/Prodato Received/Delivery	22-05	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Ni Prot Bi Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESHCK	4370/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.627/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.627/2023 të datës 07.04.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë Komuna Prizren, kundër Vendimit me numër KD.nr.15/2023 të datës 27.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 2.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.627/2023 e datës 07.04.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër KD.nr.15/2023 i datës 27.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të bëjë zbatimin e këtij vendimit, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës sipas kontratës së tij me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit _____ punësuar sipas Kontratës punës për kohë të pacaktuar (Personel Korrektues) të datës 30.06.2018 në pozitën "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren më datë 14.03.2023 ka parashtruar kërkesë me Nr. 0280/23 për inicimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me arsyetimin për mos veprimin apo lënja pas dore e detyrës së tij si zyrtar korrektues.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 27.03.2023 ka nxjerr Vendim me numër KD.nr.15/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore "*Transferimi në Institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj*".

Ankuesi kundër Vendimit me numër KD.nr.15/2023 të datës 27.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes postës më datë 05.04.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar më datë 07.04.2023 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.627/2023 me numër protokoll 3395/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.04.2023 me numër protokoll 3721/2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 05.05.2023 përmes e-mailit zyrtar ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokoll 3395/2023 të datës 07.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Fletëkthesë e datës 28.03.2023; Vendim i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me numër KD.nr.15/2023 i datës 27.03.2023; Procesverbal i A.K. i datës 21.03.2023; Procesverbal i A.K. i datës 21.03.2023; Procesverbal i A.K. i datës 21.03.2023; Procesverbal i A.K. i datës 21.03.2023; Pliko me numër R2933310 i datës 05.04.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoll 3721/2023 i datës 20.04.2023; E-mail nga Xh.I. për C.Z. i datës 05.05.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 557 e datës 05.05.2023; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar (Personeli Korrektues) e A.K. i datës 30.06.2018; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 03.01.2020; Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj A.K. me numër protokoll 0280/23 i datës 14.03.2023; Ftesë për intervistë e datës 17.03.2023; Rasti i refuzimit të urdhërit të A.K. ndaj mbikëqyrësit të lartë B.H. i datës 14.03.2023; Informatë e datës 08.03.2023; Deklaratë me nr 308/22 i datës 10.03.2023; Informat me nr. 307/23 i datës 10.03.2023; Shkresë Njësi për Transportin e të

burgosurve Shërbimi Korrektues i Kosovës e datës 08.03.2023; Shkresë Njësi për Transportin e të burgosurve Shërbimi Korrektues i Kosovës e datës 08.03.2023; Procesverbal i mbajtur me datën 25.03.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.nr.15/2023 të datës 27.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon se vendimi i lartcekur i Komisionit Disiplinor ka shkelje esenciale të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar, përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të ligjit material.

Fillimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sipas nenit 4 paragrafit 1 dhe 2, është përcaktuar se: *"1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve"*, ndërsa elementet e tjera të marrëdhënies së punës rregullohen me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës konkretisht me nenin 59 paragrafi 1, është përcaktuar se: *"1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj personelit SHKK-së, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në katër dhjetë për qind (40%) e pagës për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 1.3. transferimi në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj; 1.4. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy(2) deri në pesë (5) vjet; 1.5. ulje në pozitë; 1.6. largimi nga shërbimi civil"*.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të provave të lëndës, konstaton se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.15/2023 të datës 27.03.2023 për rastin e ankuesit me të cilin i ka shqiptuar masën disiplinore *"Transferimi në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj"*, këtë masë e ka shqiptuar duke ju referuar nenit 59 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa kualifikimin e shkeljes e ka bërë mbi bazë të nenit 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili është ligj që rregullon marrëdhënien e punës së zyrtarëve publikë, Kolegji i Këshillit, konstaton se me nenin 4 të këtij ligji janë përcaktuar në mënyrë të qartë se cilat elemente të marrëdhënies së

punës së nëpunësve profesional të Shërbimit Korrektues të Kosovës mund të rregullohen me ligj të veçantë, ndërsa çështja e procedurave disiplinore është rregulluar me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht Kolegji i Këshillit, konstaton se procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të Shërbimit Korrektues të Kosovës rregullohen vetëm me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër KD.nr.15/2023 i datës 27.03.2023 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës është i kundërligjshëm në këtë pikëpamje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Vendimi me numër KD.nr.15/2023 i datës 27.03.2023 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës është në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë konkretisht nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 ku përcaktohet se: 1.2. *ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj*; 1.3. *ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; dhe nenin 48 paragrafin 3 ku përcaktohet se: 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”, si dhe në kundërshtim me nenin 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1,dhe 1.2 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku thuhet se; 1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore”*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka nxjerr vendim me numër KD.nr.15/2023, të datës 27.03.2023, me të cilin vendim ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore *“Transferimi në Institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj”*, duke vepruar në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1,1.2,1.3,1.4,1.5,1.6 dhe 1.7, të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit. Sepse nga shkresat e lëndës del se ankuesit masa disiplinore i është shqiptuar duke bazuar në Ligjin 08/L-131 për Shërbimin Korrektues e jo ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore në fuqi Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ndërlidhur me këtë çështje juridike sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit sepse Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës masën disiplinore të shqiptuar *“Transferimi në Institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj”*, të shqiptuar me vendimin me numër KD.nr.15/2023 të datës 27.03.2023 e ka nxjerr duke u bazuar në Ligjin 08/L-131 për Shërbimin Korrektues e jo ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore në fuqi Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe Rregullorja (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.



Andaj mbi bazë të këtyre dispozitave ligjore dhe mbi bazë të kësaj gjendje faktike, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër KD.nr.15/2023 i datës 27.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe i njëjti është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht komisioni disiplinor në rastin e nxjerrjes së vendimit me numër KD.nr.15/2023 i datës 27.03.2023 ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe bazën juridike, sa i përket shqiptimit të masës disiplinore për ankuesin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se organi i punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, pas pranimit të këtij vendimi është i obliguar që ankuesin ta kthejë në vendin e punës sipas Kontratës për Kohë të Pacaktuar (Personel Korrektues) të datës 30.06.2018 në pozitën "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Prizren dhe të zbatojë Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.


Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.627/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;